



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2030/14 prot

Datë 29.08.2024

V E N D I M

Nr. 1140/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.08.2024 me

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1065/2024, datë 15.08.2024 për procedurën e prokurimit “E Hapur - Mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike Marreveshje Kuader me 1 (nje) operator ekonomik fitues per secilin Lot – ku te gjitha kushtet jane te percaktuara – me afat 12 muaj”, me **REF-06666-05-27-2024**, me objekt “Blerje produkte ushqimore për kopshtet, çerdhet, konviktin dhe shkollen Horizont” per vitin 2024, e ndare ne 5 Lote, me nr. **REF-06685-05-27-2024**, me objekt: “Loti 5: “Blerje mish dhe nënproduktet e tij”, me fond limit 14,480,108.25 lekë (pa tvsh), zhvilluar më datë 27.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit Fier.

Ankimues:

Operatori ekonomik “4 S” SHPK me Nipt. L64425401K.
Adresa: Lagjia Xhevdet Nepravishta, Rr. Qerim Arapi, Zona Kadastrale 8571, Godina 196, Pasuria nr. 23, Lushnje.

Autoriteti Kontraktor:

Qendra Ekonomike e Arsimit Fier.
Adresa: Lagja “29 Nëntori”, Rruga “Kastriot Muço”, Fier.

Subjekt i interesuar:

Operatori ekonomik “Argent Daci” P.F, me NIPT L01914003T dhe adresë Rruga Abdi Bej Toptani, godina nr.21, poshte ktheses se Valiasit, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I***Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 15.08.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1065/2024, ku vendosi:

1. Të pranohet ankesën e operatorit ekonomik “4 S” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-06685-05-27-2024, me objekt: “Loti 5: 13 “Blerje mish dhe nënproduktet e tij”, me fond limit 14,480,108.25 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Fier.

2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e kualifikimit të operatorit ekonomik “4 S” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar atë.

3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “4 S” SHPK.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 667/4 prot., datë 23.08.2024, protokolluar me tonën nr. 2030/11 prot., datë 26.08.2024 autoriteti kontraktor, njofton se: [.....Ju informojmë se Autoriteti ynë Kontraktor kreu veprime në SPE për rivlerësimin e procedurës së prikurimit sipas Vendimit të sipërcituar.....].

Bashkëlidhur:

-Procesverbal me nr.642/3 prot., datë 22.08.2024 Mbi rivlerësimin;

-Vendim nr. 667 prot., datë 20.08.2024 Mbi zbatimin e KPP 1065/2024;

II**Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 667/4 prot., datë 23.08.2024, protokolluar me tonën nr. 2030/11 prot., datë 26.08.2024 autoriteti kontraktor, njofton se: [.....Ju informojmë se Autoriteti ynë Kontraktor kreu veprime në SPE për rivlerësimin e procedurës së prikurimit sipas Vendimit të sipërcituar.....].

Bashkëlidhur:

-Procesverbal me nr.642/3 prot., datë 22.08.2024 Mbi rivlerësimin;

-Vendim nr. 667 prot., datë 20.08.2024 Mbi zbatimin e KPP 1065/2024;

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, lidhur me zbatimin e vendimit Nr. 1065/2024, datë 15.08.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga ky verifikim rezultoi se, autoriteti kontraktor kreu rivlerësimin në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) të ofertave, duke rishikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “4S” SHPK, si dhe ka korrigjuar shkeljet e konstatuara për operatorin ekonomik ankimues, në zbatim të vendimit të KPP Nr. 1065/2024, datë 15.08.2024, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E Hapur - Mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike Marreveshje Kuader me 1 (nje) operator ekonomik fitues per secilin Lot – ku te gjitha kushtet jane te percaktuara – me afat 12 muaj”, me **REF-06666-05-27-2024**, me objekt “Blerje produkte ushqimore për kopshtet, çerdhet, konviktin dhe shkollen Horizont” per vitin 2024, e ndare ne 5 Lote, me nr. **REF-06685-05-27-2024**, me objekt: “**Loti 5: “Blerje mish dhe nënproduktet e tij”, me fond limit 14,480,108.25 lekë (pa tvsh)**, zhvilluar më datë 27.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit Fier.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

